



WWW.AMCHAM.COM.AL

American Chamber of Commerce in Albania

TAX ALERT

PAKETA FISKALE 2020

PAKETA FISKALE 2020

Këshilli i Ministrave i dërgoi Kuvendit propozimet e tij për ndryshimin e legjislacionit fiskal ("Paketa Fiskale 2020"). Paketa Fiskale u miratua nga Kuvendi më 18 dhjetor 2019 dhe u publikua në Fletoren Zyrtare më 31 dhjetor 2019.

Më poshtë do të gjeni një përmbledhje të ndryshimeve më të rëndësishme që sjell Paketa Fiskale në disa ligje.

Ligji për tatimin mbi të ardhurat (Ligji nr. 8438/1998)

Ligji i ri "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438/1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", parashikon ndryshimet në vijim:

Deklarata vjetore e të ardhurave që duhet të paraqitet nga individët e punësuar në më shumë se një punëdhënës

Individët, të cilët janë të punësuar në më shumë se një punëdhënës u kërkohet të plotësojnë deklaratën vjetore të të ardhurave, pavarësisht nga shuma e të ardhurave totale vjetore (d.m.th. edhe nëse të ardhurat e tyre janë nën pragun prej 2 milion Lekë). Këta individë do të duhet të deklarojnë në deklaratën e tyre vjetore të ardhurat nga punësimi në një shumë të vetme dhe të llogarisin shumën totale të detyrimit tatimor bazuar në normat e tatimit progresiv. Punonjësit do të paguajnë detyrimin tatimor në favor të buxhetit të shtetit pasi të kenë zbritur tatimin e mbajtur nga punëdhënësi gjatë vitit (nëse ka).

Transferimi i pasurive të paluajtshme ndërmjet anëtarëve të familjes

Kalimi i të drejtës së pronësisë për banesën dhe/ose truallin ndërmjet anëtarëve të familjes (si midis bashkëshortit dhe bashkëshortes, dhe femijëve), përmes dhurimit dhe/ose heqjes dorë nga e drejta e pronësisë,

përfshihet nga tatimi mbi të ardhurat personale. Vetëm një transferim i së drejtës së pronësisë për secilin përfitues është i përjashtuar. Transferimet e tjera i nënshtrohen taksës mbi të ardhurat personale.

Shpenzime të zbritshme për eksportuesit

Shpenzimet për pjesëmarrjen në panaire apo ekspozita jashtë vendit, të bëra nga tatimpaguesit eksportues njihen si shpenzime tatimore të zbritshme deri në 3% të xhiros vjetore. Për të përfituar nga ky rregull, tatimpaguesi duhet të ketë realizuar më shumë se 70 për qind të të ardhurave nga eksporti gjatë tre viteve të fundit. Prodhuesit që punojnë me materialet e porositesit (*fason*) nuk kualifikohen si eksportues për qëllime të kësaj dispozite.

Sponsorizimi i ekipeve sportive

Kur personat juridikë që realizojnë një fitim të tatueshëm vjetor prej më shumë se 100 milion Lekë sponsorizojnë ekipe sportive të federatave të njohura, do t'iu njihet si shpenzim i zbritshëm për efekt fiskal një shumë sa trefishi i shumës së sponsorizuar. Zbritja nuk lejohet të mbartet për periudhat e ardhshme tatimore. Shuma e sponsorizimit nuk duhet të kalojë kufijtë e përcaktuar në ligjin nr. 7892, datë 21.12.1994 "Për sponsorizimin". Për të përfituar nga zbritja, sponsori duhet të marrë një "autorizim sponsorizimi" nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve sipas procedurave që do të detajohen në një udhëzim të Ministrit të Financave.

Mbartja e humbjes

Tatimpaguesit që investojnë në projekte biznesi në një vlerë më shumë se 1 miliardë Lekë, kanë të drejtë të mbulojnë humbjet me fitimet në 5 vitet e ardhshme (tatimpaguesit e tjerë do të vazhdojnë të mbartin humbjet e tyre deri në 3 vjet). Ministri i Financave do të përcaktojë përmes një udhëzimi kriteret për zbatimin e kësaj dispozite.

Ulja e shkallës së tatimit mbi fitimin për industrinë automotive

Personat juridikë që kryejnë veprimtari ekonomike në industrinë automotive i nënshtrohen tatimit mbi fitimin në masën 5%. Këshilli i Ministrave do të përcaktojë me vendim aktivitetet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj dispozite.

Taksimi i fitimit të kapitalit nga shitja e aksioneve/kuotave

Ligji i ri sqaron se dispozitat e një marrëveshjeje tatimore për shmangien e tatimit të dyfishtë mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin kanë përparësi ndaj ligjit shqiptar në lidhje me taksimin e fitimeve kapitale nga shitja e aksioneve/kuotave.

Konkretisht, rregullat për taksimin e fitimit të kapitalit nga shitja e aksioneve/kuotave (sipas të cilave transferohet detyrimi tatimor nga shitësi i aksioneve tek shoqëria, aksionet e së cilës po transferohen) nuk do të zbatohen në rast se një marrëveshjeje tatimore rregullon taksimin e transferimit të këtyre aksioneve/kuotave.

Ligji për Procedurat Tatimore (Ligji nr. 9920/2008)

Ligji i ri "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9920/2008 "Për Procedurat Tatimore" parashikon ndryshimet e mëposhtme:

Kompensimi i detyrimeve tatimore me kredi doganore dhe anasjelltas

Është parashikuar mundësia për të përdorur kreditë ndaj autoriteteve tatimore ose doganore për pagimin e detyrimeve ndaj autoritetit tjetër.

Për këtë qëllim, shumat që duhet të paguhen ose që janë paguar për administratën tatimore mund të kompensohen me shumat që duhet të paguhen ose që janë paguar për administratën doganore. Sidoqoftë, ky përfitim do të zbatohet vetëm për raste specifike. Ministri i Financave do të përcaktojë me anë të një udhëzimi kriteret për zbatimin e kësaj dispozite dhe cilat entitete do të përfitojnë prej saj.

Rimbursimi i TVSH-së përmes kësteve

Në raste specifike, me kërkesë të administratës tatimore, mund të nënshkruhet një marrëveshjeje për pagesën përmes kësteve të detyrimeve që autoritetet tatimore kanë ndaj tatimpaguesve për pagimin e shumave të TVSH-së së miratuar për rimbursim.

Kur nënshkruhet një marrëveshjeje e tillë, detyrimi i autoriteteve tatimore ndaj tatimpaguesit konsiderohet i shlyer dhe nuk do të aplikohen kamatëvonesa. Procedurat për aplikimin e kësaj dispozite do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjobat për shkelje të rregullave lidhur me sistemin e ri të faturimit elektronik

Ligji i ri ndryshon të gjitha dispozitat që përcaktojnë gjobat për shkeljet në lidhje me përdorimin e pajisjeve /

programeve fiskale dhe mungesën e pajtueshmërisë me sistemin e ri të faturimit elektronik. Çdo lloj gjobe është parashikuar në tre nivele, shuma më e ulët për tatimpaguesit që nuk janë regjistruar për TVSH (xhiro vjetore deri në 2 milion Lekë), kategoria e dytë për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar të fitimit (qarkullimi vjetor deri në 8 milion Lekë), dhe gjobat më të larta zbatohen për tatimpaguesit që janë regjistruar për tatimin mbi fitimin (qarkullimi vjetor më shumë se 8 milion).

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (Ligji nr. 92/2014)

Ndryshime janë bërë edhe në Ligjin e TVSH-së.

Automjete elektrike

Furnizimi i automjeteve të reja elektrike (që kanë vetëm motor elektrik) dhe që nuk janë të regjistruar në asnjë shtet tjetër, do të përjashtohet nga TVSH-ja (përfshirë importin ose furnizimet brenda vendit).

Furnizimi i automjeteve elektrike të përdorura për transport publik (në më shumë se 9 vende) do t'i nënshtrohet nivelit të ulur të TVSH-së prej 6 për qind (më parë norma në fjalë ishte e zbatueshme vetëm gjatë një afati të kufizuar deri më 31 dhjetor 2021 dhe pas kësaj do të rritej në 10 për qind).

Përfshirja e TVSH-së për procesin e rindërtimit

Furnizimi i shërbimeve për ndërtimin e ndërtesave të shkatërruara nga tërmeti do të përjashtohet nga TVSH-ja gjatë procesit të rindërtimit. I njëjti përjashtim u jepet furnizuesve të drejtpërdrejtë të ndërtuesve për shërbime dhe mallra të blera gjatë procesit në fjalë. Përfshirja duhet të autorizohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Këshilli i Ministrave do të përcaktojë procedurën e përjashtimit të TVSH-së.

Afati për lëshimin e faturës për auto-ngarkesën e TVSH-së

Tatimpaguesi është i detyruar të lëshojë faturën e auto-ngarkesës së TVSH-së brenda datës 10 të muajit që pason muajin e furnizimit (më parë, afati i fundit ishte data 14 e muajit tjetër).

Harmonizimi i ligjit të TVSH-së me sistemin e ri të faturave elektronike

Ligji i TVSH-së ka pësuar disa ndryshime në mënyrë që të harmonizohet me rregullat e reja të parashikuara në ligjin "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i cili synon të zëvendësojë faturat aktuale (faturat e para-shtypura, të cilat plotësohen me dorë) me faturat elektronike.

Hyrja në Fuqi

Paketa Fiskale 2020 do të hyjë në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të dispozitave që lidhen me zbatimin e ligjit "Për faturat dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", të cilat do të aplikohen sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj.